



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.88/2024

Prishtinë, më 7.5.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Arjeta Fejza, Albana Bytyçi, Nasuf Bejta, Drita Millaku, Fatmire Kollçaku, Ariana Musliu- Shoshi, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Mungoi: Labinotë Demi- Murtezi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e lartë në Komision.

Pjesëmarrës të tjerë: Mentor Hyseni-AKP, Arben Limani-AKP, Syzana Dautaj-AKP, Malsor Sylja-KosovaPress, Edita Kosumi-EUSR, Ema Krasniqi-KDI dhe Hysni Mehani-GP LV.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim në Komision, lidhur me peticionin e punëtorëve të AKP-së;
Të ftuar: kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe drejtori Ekzekutiv i AKP-së;
3. Shqyrtimi i propozim-raportit me rekomandime, lidhur me raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim në Komision, lidhur me peticionin e punëtorëve të AKP-së;

Të ftuar: kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe drejtori Ekzekutiv i AKP-së

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit për çështjen për të cilën do të diskutohet dhe më pas fjalën ia kaloi kryesuesit të Bordit Drejtorëve të AKP-së.

Mentor Hyseni, njoftoi se në parim kanë ftuar grupin e grave që kanë përgatitur peticionin dhe mbas një kërkese që i është bërë Bordit, i kanë takuar dhe kanë diskutuar në detaje të gjitha çështjet dhe shqetësimet që kanë ngritur ato. Madje, shtoi se ka dëgjuar në detaje edhe deklarin publik të përfaqësueses së peticionit, që ishte në takim në Komision. Po ashtu, e përgëzoi për iniciativën e ngritjes së çështjes së pabarazisë gjinore, që ndodhet në AKP, por edhe në të gjitha institucionet tjera.

Barazia gjinore është temë mjaft e thellë në Kosovë, por jo vetëm në Kosovë. Pastaj, njoftoi se në AKP janë 209 persona të punësuar, rreth 46 % prej tyre janë femra dhe 53.6% janë meshkuj.

Si bord, tha se kanë filluar në vitin 2021, ku përqindja ka qenë diku 40% gra dhe diku 60% burra. Në vitin 2022 ka ndërruar në favor të grave, që është bërë 46.10% gra dhe 53.9% burra. Në vitin 2023, si rezultat përfundimtar, 46.57% gra dhe 53.3% burra dhe nga këto statistika shihet një trend i ngritjes se nivelit të barazisë gjinore në këtë institucion.

Është e vërtetë, ashtu siç ka thënë përfaqësuesja e peticionit, se pozitat e larta në AKP kryesohen kryesisht nga meshkujt.

Si bord nuk kanë mandat për t'iu thënë burimeve njerëzore, që është e thirrur për të respektuar një ligj, të cilin e ka miratuar Kuvendi i Kosovës, e për t'iu thënë se nëse dikush, edhe nëse nuk i plotëson kushtet, duhet me qenë në listë, sepse shkelim mbi të drejtat bazike të njeriut, që është barazia para ligjit. Sikur të ishin dy kandidatë që janë një grua dhe një burrë, atëherë kishim mundur të themi që bordi ka faj pse nuk ka anuar nga ana e gruas, edhe atëherë nëse kish qenë me pikë më pak, ka qenë mundësia për të bërë shkelje, se ligji thotë vetëm nëse janë të barabartë edhe me pikë, por në këtë rast, si bord nuk kemi pasur asnjë kandidate grua, që i ka plotësuar kushtet teknike profesionale.

Në këtë kontekst, mundem mund të them se çështjet gjinore kanë histori në Kosovë, por edhe në botë, për faktin që historia e gjinisë i ka përcjellë që meshkujt kanë pasur përparësi të kenë përvojë pak më shumë, pasi që femrat kur bëhen nëna, disa vite dedikohen në rritjen e fëmijëve. Për ato vite ngecin në përvojë profesionale, në krahasim me meshkujt dhe duhet një përpjekje kolektive e gjithë shoqërisë për t'i barazuar këto gjëra.

Tha se garanton se në bazë të kriterëve që janë të bazuar në Ligj për zyrtarët publikë, askush në AKP nuk guxon t'i shkelë, duke e diskriminuar një person në bazë gjinore, sepse jemi rojtarë të ligjit dhe çdo gjë që miratohet në Kuvend, jemi të obliguar ta respektojmë.

Syzana Dautaj, tha se në Bordin e AKP-së, janë 8 anëtarë të Bordit dhe nga ta janë 3 femra dhe 5 meshkuj. Në përgjithësi, Bordi ka qenë shumë i interesuar që kur janë shpallur konkurset, të ketë femra dhe pretendonte për këto pozita të dy zëvendësrejtoreve dhe kemi pasur pretendonte vetëm një femër dhe ajo nuk i ka plotësuar kriteret teknike të këtij konkursi. Tha se prej se janë në Bord, është bërë një përmirësim i statistikave në favor të grave dhe kjo nuk është e mjaftueshme, mund të bëjnë edhe më shumë, sepse në AKP ka femra shumë të ngritura dhe e meritojnë ngritjen në pozitë.

Mentor Hyseni, tha se në AKP, përveç punëtorëve që janë, me Ligjin për zyrtarët publikë, kanë edhe ofruar të shërbimeve që marrin me kontrata të përkohshme. Në vitin e kaluar i kanë marrë 29 punëtorë dhe 20 prej tyre kanë qenë femra dhe 9 meshkuj.

Çdo reflektimi i këtij peticioni që e përfaqëson znj.Gjonbalaj, është një iniciativë për të ngritur ndërgjegjen për një reflektim gjithë shoqëror dhe duhet përpjekje kolektive, jo vetëm për AKP-në.

Arjeta Fejza, tha se kur ishte përfaqësuesja e peticionit në Komision, dëgjuan disa statistika shqetësuese, ishte një koment se gratë kanë hezituuar për të ardhur në Komision, për faktin se kanë pasur frikë se do të penalizohen në punën e tyre dhe në mundësinë që të avancohen brenda institucionit. Në Republikën e Kosovës, askush nuk duhet të ketë frikë nga askush, për ta adresuar një peticion dhe asnjë institucion nuk ka të drejtë të hakmerret ndaj dikujt, se ka adresuar peticion në këtë Komision.

Tha se një ndër çështjet që është adresuar me këtë peticion, kanë të bëjnë me një shtresëzim të pabarazisë ndër vite. Modaliteti që është përdorur për t'iu dhënë hapësirë burrave në këtë institucion, sipas nënshkrueseve të peticionit, ka qenë diskriminues, sepse kurdoherë që ka pasur mundësi për t'u ngritur në detyrë brenda institucionit, gjithmonë u është dhënë përparësi burrave. Bordi aktual e ka për obligim të hartojë politika përkrahëse, të cilat e mbështesin dhe e fuqizojnë avancimin e grave brenda institucionit, sepse edhe ligji e njeh që të përkrahet gjinia e nën- përfaqësuar.

Mentor Hyseni, tha se statistikat që i paraqet, dëshmojnë se në tri vitet e fundit ka një ndryshim radikal, sa i përket përkrahjes së femrave në AKP, dhe kjo ka qenë edhe një nxitje e znj. Drita, që për ta ngritur këtë çështje më tutje, që nuk është ngritur asnjëherë përpara.

Arben Limani, tha se pajtohet që nuk duhet askush, dhe nuk ka të drejtë ligjore të kërcënojë askënd që e kërkon një të drejtë. Po ashtu, tha se siguron që në asnjë rast dhe pa përjashtim prej menaxhmentit nuk ka pasur as edhe një diskutim që të ndalohej, të sanksionohet, apo të kufizohet ky peticion.

Shtoi se disa nga deklaratimet e përfaqësueses së peticionit i ka marrë me shqetësim, si ato që ka diskriminim të jashtëzakonshëm, barazia gjinore është inekzistente etj. Këto janë absolutizma dhe e fton Komisionin që secilin detaj të deklaratimeve që janë bërë aty, që kanë potencialisht konotacion edhe tjetër, t'i hetojë dhe është i hapur për bashkëpunim.

Kryetarja pyeti: A është peticioni i bazuar dhe a keni ndonjë ide sesi mund t'i i rregulloni këto, që janë konsideruar si padrejtësi?

Mentor Hyseni, tha se për mendimin e tij, nëse një grua e ngrit një çështje në Kosovë, është më të drejtë, dhe për atë që si kryesues i Bordit, së bashku me zëvendëskryesuesen, i kanë pritur 1 orë e gjysmë në takim dhe kanë biseduar për secilën çështje që ato e kanë ngritur. Se a ka mekanizëm për ta rregulluar atë, tha se beson se është përpjekje kolektive e AKP-së dhe duhet përpjekje kolektive e shoqërisë për ta rregulluar barazinë gjinore.

Kryetarja, tha se jeni duke e shfajësuar veten, duke i gjeneralizuar gjërat. Po ashtu, i intereson ta dijë se çka është bërë në AKP-në, që të jetë më në rregull se në institucionet e tjera, sepse ato që e kanë bërë peticionin, e kanë pakënaqësinë këtu.

Mentor Hyseni, tha se ka dhënë tri statistika, të cilat tregojnë përmirësim për përkrahjen e gruas në AKP. Nëse flasim për individë, as ju si deputetë nuk kishit pasur guximin për të kualifikuar dikë për një pozitë të drejtuesit të lartë, që ligji nuk e lejon.

Ariana Musliu- Shoshi, tha se dihet që në administratën publike janë më shumë se 70% të punësuarat gra dhe nën 10% në pozita drejtuese, që gratë nuk janë të favorizuara në pozita drejtuese, duhet të fillohet nga Kuvendi i Kosovës. Që nga 14 drejtori dhe tri drejtori të përgjithshme, kanë arritur vetëm dy femra të jenë në pozitën drejtoreshës, dhe nëse nisemi me barazi gjinore, ne si deputete duhet të nisemi së pari nga institucioni ku

jemi. Gratë janë të kualifikuara, por nuk e dimë pse është ky fenomen në shoqërinë tonë. Në administratë duhet pa-tjetër që grave t'u jepet përparësi, sidomos kur bëhet fjalë për pozitat udhëheqëse dhe duhet të rregullohet kjo. Pra, duhet të fillohet nga Kuvendi, të marrim iniciativë, kjo të jetë e detyrueshme me ligj.

Fatmire Kollçaku, tha se ishte këtu përfaqësuesja e peticionit, e cila ishte një grua mjaft kompetente në prezantimin e saj, ajo paska një masë disiplinore, që menjëherë është një parakusht që në avancim, ajo është një pengesë. Më tej, tha se i intereson pse i është shqiptuar ajo masë disiplinore. Ligji për Barazi Gjinore kërkon të merret parasysh komponenti i barazisë gjinore.

Është pritur që në këtë takim, të na thuhet se qasja e juaj është në avancimin e barazisë gjinore, që do të rishikoni edhe këtë peticion dhe të shikohen modalitete, që të krijohen parakushte që një gruaje t'i jepet përparësi për të pasur një lloj përvojë, e cila më vonë i mundëson të ecë në pozita më të larta drejtuese.

Drita Millaku, tha se jemi këtu për të diskutuar për çështjet e ngritura në peticion për ngritjen nëpër detyra profesionale apo pozita drejtuese të grave në AKP. Inkurajoj të gjitha gratë, që mos të mbesin tek ajo kuotë që i përcaktohet, mirëpo të kërkojnë të drejtat e veta, jo t'i falen, por t'i kërkojë me punë dhe të bëhet avancimi në detyrë. Përpjekjet asnjëherë nuk duhet të ndalen për të arritur deri te një qëllim, që është më i mirë edhe për institucionin, por edhe për vendin tonë.

Eliza Hoxha, tha se në 46% është rritja në favor të grave. A është në punësim apo në pozita udhëheqëse? Në shume ligje, te pozitat udhëheqëse, kërkohet përvoja menaxheriale dhe kjo fjali i privon gratë e shumta që punojnë 20 vite në një institucion, si në AKP, duke i lënë mundësi një burri që shumë lehtë të vijë në pozitë me një përvojë menaxheriale, në çdo sektorë nga jashtë. Kjo problematikë haset edhe tek institucionet e tjera apo ndodh edhe te punësimi për herë të parë, ku kërkohet përvojë pune.

Ajo shtoi se përvoja e punës duhet të nisët nga diku, duhet dhënë besimin dikujt, për të kuptuar se sa mund të performojë.

Pyeti përfaqësuesit e AKP-së: Cilat janë masat afirmative që janë menduar të përdoren, për të mbërritur që të plotësohet kuota 50/50, jo vetëm në punësim, por edhe në pozita udhëheqëse?

Mentor Hyseni, tha se pjesa e legjislacionit që i determinon si Bord, është Ligji për zyrtarët publikë. Emërimet, deri tani, kanë qenë dy dhe nuk ka pasur kandidatë grua dhe tha se çka kanë pasur mundësi për të bërë, e kanë bërë.

Tha se po flitet për një diskriminim gjinor, që ka ndodhur në të kaluarën në institucion dhe tani mjetet që i kanë në shfrytëzim janë shumë të kufizuara për bordin, për të bërë diçka për pozitat drejtuese.

Syzana Dautaj, tha se ky peticion është pozitiv dhe këtë e kanë ngritur edhe në bord. Ky peticion po tregon një ambicie të grave, që punojnë në AKP. Pra, tregon se ato nuk kanë frikë nga askush për të ngritur pakënaqësi dhe ndihen të fuqizuara. Diskutimi që u bë në këtë takim, mendon se është shumë pozitiv.

Marigona Geci, tha se kur ishte zonja Gjonbalaj në Komision, ishte shqetësuese se 23 gra të tjera nuk kishin guximin të vijnë në takim, për t'i i shprehur shqetësimet e tyre për pozitat e larta menaxhuese.

Ne si Komision kemi parë përmes këtij peticioni se 90% e punëtoreve gra të AKP-së, janë në pozita të ulëta. Pse është dashur të pritët të vijë ky peticion në Kuvendin e

Kosovës e Bordi mos ta ngre këtë çështje deri më tani? Cilat janë kriteret që mendoni për t'i plotësuar, për të pasur plotësim të kriterit të barazisë gjinore në të gjitha institucionet, përfshirë edhe AKP-në?

Ajo shtoi se nuk mund të plotësohet kriteri i përvojës menaxheriale, pa u emëruar në pozitë menaxheriale.

Arjeta Fejza, tha se në nenin 5 të Ligjit për barazi gjinore, thuhet se me qëllim të parandalimit të eliminimit të diskriminimit, të arritjes së barazisë gjinore, institucionet e Republikës së Kosovës të të gjitha niveleve, janë përgjegjëse për të zbatuar masat legislative dhe masat tjera, duke përfshirë miratimin e strategjive dhe planeve për veprimin e promovimit të barazisë gjinore. Tha se një prej elementeve që e ka obligim secili institucion, që kur ngrit kapacitete dhe do të ngrejë resurse, e ka obligim respektimin e barazisë gjinore, qoftë kur bëhen emërimet, trajnime, etj. Po më duket që kjo në AKP ka munguar.

Mentor Hyseni, tha se politika apo strategjia që ka qenë në dorën e tyre, është që këta ofruesit e shërbimeve që i kanë marrë pa iu nënshtruar Ligjit për zyrtarë publikë dhe janë bërë 69% gra dhe 31% burra, dhe kur ka qenë pjesa e ristrukturimit, 80% burra kanë mbetur pa u sistemuar dhe vetëm 20% gra. Tha se sa i përket pozitave të larta, janë duart e lidhura, sepse e shkel të drejtën themelore të njeriut, sepse shkelet barazia para ligjit.

Arben Limani, tha se Ligji për zyrtarët publikë, duhet të shikohet te vitet e përvojës së punës për pozita dhe të bëhet një përmirësim aty ku thuhet 5 vite përvojë pune menaxheriale, të jenë të zëvendësueshme me 10 apo 15 vite përvojë pune zyrtar në institucion dhe në lëmin e caktuar.

Kryetarja, tha se si Komision duhet dhënë një përgjigje, lidhur me petitionin që kanë pranuar në mënyrë zyrtare. Në vijim, tha se tani kemi informacionet nga të dy palët, dhe se shpreson se si Bord keni vullnet, brenda mundësive, për t'u marrë me zgjidhjen e problemit, sepse beson se peticioni është bërë duke u bazuar në fakte. Po ashtu, shtoi se si Komision, janë në dispozicion të ndihmojnë, kurdo që keni nevojë.

3. Shqyrtimi i propozim-raportit me rekomandime, lidhur me raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022

Kryetarja, tha se propozim-raportin me rekomandime, lidhur me raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022, e kanë pranuar me kohë dhe është në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.

Kryetarja hodhi në votim raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022, dhe konstatoi se Komisioni, me të gjitha votat për, miratoi raportin me rekomandime, si në vijim:

Rekomandime

- I. Kuvendi të miratojë raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2022.
- II. Duke u bazuar në nenin 135.1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- III. Arsyetimin e raportit me rekomandime në Kuvend, do ta paraqesë deputetja Duda Balje, kryetare e Komisionit FunkSIONAL.

4. Të ndryshme

Nuk pati çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Duda BALJE,
Kryetare e Komisionit